

**LIGJI Nr. 08/L-056**

**PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**PËRMBAJTJA**

**KAPITULLI I.  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

- Neni 1. Qëllimi
- Neni 2. Fushëveprimi
- Neni 3. Përkufizimet
- Neni 4. Tregu përkatës

**KAPITULLI II.  
MARRËVESHJET**

- Neni 5. Marrëveshjet e ndaluara (kartelet)
- Neni 6. Përrjashtimi grupor
- Neni 7. Marrëveshjet me rëndësi të vogël

**KAPITULLI III.  
POZITA DOMINUESE**

- Neni 8. Përcaktimi i pozitës dominuese
- Neni 9. Keqpërdorimi i pozitës dominuese
- Neni 10. Konstatimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese

**KAPITULLI IV.  
PËRQENDRIMET**

- Neni 11. Përqendrimi
- Neni 12. Përqendrimet e ndaluara
- Neni 13. Detyrimi për të kërkuar lejin e përqendrimit
- Neni 14. Përqendrimi i institucioneve financiare
- Neni 15. Parashtrimi i kërkesës për lejin e përqendrimit
- Neni 16. Përmbajtja e kërkesës për lejin e përqendrimit
- Neni 17. Procedura e vlerësimit të përqendrimit
- Neni 18. Vërtetimi dhe vendimi për lejin e përqendrimit
- Neni 19. Shfuqizimi dhe ndryshimi i vendimit për lejin e përqendrimit
- Neni 20. Masat pas realizimit të paligjshëm të përqendrimit

## KAPITULLI V. AUTORITETI

- Neni 21. Përcaktimi i Autoritetit
- Neni 22. Komisioni
- Neni 23. Kushtet për të qenë anëtar i Komisionit
- Neni 24. Shkarkimi i anëtarit të Komisionit
- Neni 25. Kryetari i Autoritetit
- Neni 26. Përgjegjësitë e Komisionit
- Neni 27. Mbledhjet dhe vendimmarrja e Komisionit
- Neni 28. Sekretariati
- Neni 29. Përgjegjësitë e Sekretariatit
- Neni 30. Drejtori i Përgjithshëm
- Neni 31. Konflikti i interesit

## KAPITULLI VI. MENDIMI PROFESIONAL DHE REKOMANDIMET

- Neni 32. Mendimi profesional dhe rekomandimet e Autoritetit

## KAPITULLI VII. PROCEDURAT

- Neni 33. Rregullat e procedurës në përgjithësi
- Neni 34. Palët në procedurë
- Neni 35. Propozimi për fillimin e procedurës
- Neni 36. Fillimi i procedurës
- Neni 37. Konkluzioni për fillimin e procedurës
  
- Neni 38. Njoftimi, të drejtat dhe detyrimet e palës
- Neni 39. Mbledhja e të dhënave
- Neni 40. Kontrolli i paparalajmëruar në objektet e palës
- Neni 41. Kontrolli i paparalajmëruar në objekte të personave të tjerë
- Neni 42. Zbatimi i kontrollit të paparalajmëruar
- Neni 43. Përjashtimi i dokumentacionit në kontrollin e paparalajmëruar
- Neni 44. Procesverbali i kontrollit të paparalajmëruar
- Neni 45. E drejta e qasjes në dosje
- Neni 46. Njoftimi i konstatimit të fakteve
- Neni 47. Marrja e detyrimeve
- Neni 48. Seanca dëgjimore
- Neni 49. Masat e përkohshme
- Neni 50. Konstatimi i kushteve për shqiptimin e gjobës
- Neni 51. Fshehtësia tregtare
- Neni 52. Ruajtja e dosjeve dhe dokumentacionit
- Neni 53. Zyrtarët e përjashtuar
- Neni 54. Afatet e vendimmarrjes
- Neni 55. Aktet e Autoritetit
- Neni 56. Dorëzimi dhe publikimi i akteve të Autoritetit

## KAPITULLI VIII. DISPOZITAT NDËSHKUESE

- Neni 57. Gjobat për shkelje të rënda
- Neni 58. Gjobat për shkelje të lehta
- Neni 59. Gjobat për shkeljet nga personat përgjegjës
- Neni 60. Pagesat ndëshkuese periodike
- Neni 61. Mënyra dhe kriteret e shqiptimit të gjobave
- Neni 62. Lirimi nga gjoba dhe zvogëlimi i gjobës

## KAPITULLI IX. BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA DHE MBROJTJA GJYQËSORE

- Neni 63. Mjetet juridike kundër shkaktimit të dëmit  
Neni 64. Bashkëpunimi i Autoritetit me gjyqësorin dhe organet e tjera  
Neni 65. Bashkëpunimi i Autoritetit me institucionet simotra  
Neni 66. Mbrojtja gjyqësore

#### KAPITULLI X. PËRMBARIMI I GJOBAVE DHE PARASHKRIMI

- Neni 67. Përmbardimi i gjobave  
Neni 68. Parashkrimi i ndjekjes  
Neni 69. Parashkrimi i përmbardimit

#### KAPITULLI XI. DISPOZITAT KALIMTARE

- Neni 70. Legjislacioni në fuqi dhe detyrimet ndërkombëtare  
Neni 71. Aktet nënligjore  
Neni 72. Dispozita shfuqizuese  
Neni 73. Hyrja në fuqi

### KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Qëllimi

1. Ky ligj përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat dhe organizimin e Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, si dhe procedurat për zbatimin e këtij ligji.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me këto akte të Bashkimit Evropian:

2.1. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave për konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;

2.2. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 139/2004 e 20 janarit 2004 për kontrollin e përqendrimeve mes ndërmarrjeve (Rregullorja e Bashkimit të KE-së);

2.3. Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 330/2010 e 20 prillit 2010 për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian në kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara;

2.4. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 802/2004 e 7 prillit 2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 139/2004 e 20 janarit 2004 për kontrollin e përqendrimeve mes ndërmarrjeve.

#### Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit, nëse veprimet e tyre kanë efekt në tregun e Republikës së Kosovës.

2. Për atë që nuk u pengon në detyrat që u janë caktuar me ligj ose për të cilat janë themeluar,

ky ligj zbatohet ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe që sipas ligjit:

- 2.1. kryejnë shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik;
  - 2.2. kanë karakterin e një monopoli që krijon të hyra;
  - 2.3. kanë të drejta ekskluzive.
3. Ky ligj nuk zbatohet për marrëdhëniet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve, si dhe për marrëdhëniet që janë objekt i kontratës kolektive mes punëdhënësit dhe sindikatës.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet e përcaktuara në këtë nen.
2. **Marrëveshje**-marrëveshjet e çdo forme, të lidhura mes ndërmarrjeve, me ose pa fuqi detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara mes ndërmarrjeve që veprojnë në të njëjtin nivel ose në nivele të ndryshme të tregut.
3. **Praktikë e bashkërenduar**-aktiviteti që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal mes ndërmarrjeve dhe që nuk mbështetet në një vendim ose marrëveshje formale.
4. **Autoriteti** - Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, i themeluar me këtë ligj.
5. **Organ publik**-organi i administratës publike qendrore ose lokale ose personi juridik me funksion publik.
6. **Komisioni**-struktura vendimmarrëse e Autoritetit.
7. **Pozitë dominuese**- fuqia ekonomike që gëzon ndërmarrja dhe që i mundëson të parandalojë konkurrencën efektive në tregun përkatës, duke i dhënë fuqinë të silltet në masë të konsiderueshme e pavarur nga konkurrentët, blerësit dhe konsumatorët.
8. **Treg përkatës**-tregu i produktit të caktuar në zonë gjeografike të caktuar.
9. **Përçendrim** - krijimi i ndërmarrjes së përbashkët nga ndërmarrje të pavarura që në bazë të qëndrueshme kryejnë të gjitha funksionet si subjekte ekonomike të pavarura.
10. **Ndërmarrje**- çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit. Organi publik quhet ndërmarrje nëse angazhohet në veprimtari ekonomike.
11. **Ndërmarrje të lidhura**-ndërmarrje që, për shkak të kontrollit të ndërsjellë ose ndërvarësisë, quhen ndërmarrje e vetme kur llogariten të ardhurat e përbashkëta dhe pjesëmarrja e përbashkët në treg. Ndërmarrjet quhen të lidhura kur njëra ndërmarrje në raport me tjetrën, drejtpërdrejt ose tërthorazi:
  - 11.1. zotëron më shumë se gjysmën e kapitalit ose të aseteve;
  - 11.2. ka fuqinë për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votimit;
  - 11.3. ka fuqinë për të emëruar mbi gjysmën e anëtarëve të bordit drejtues, bordit menaxhues ose të organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen;
  - 11.4. ka të drejtë të drejtojë punët e ndërmarrjes; ose
  - 11.5. përfshin subjekte ekonomike që përbëhen secila nga një organizatë unitare me

elemente personale, të prekshme dhe të paprekshme, e cila ndjek qëllim të caktuar ekonomik në bazë afatgjate dhe mund të kontribuojë në shkëlqen e këtij ligji.

12. **Veprimtari ekonomike** - blerja e mallrave ose shërbimeve vetëm nëse përdorimi pasues i mallrave ose shërbimeve të blera përbën veprimtari ekonomike.

13. **Institucion simotër**- organi i konkurrencës i shtetit tjetër ose i organizatës sipërkombëtare si dhe shoqatat e tyre.

14. Përdorimi i njëjësit ose njëres gjini gramatikore nuk përjashton shumësin ose gjininë tjetër, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

#### **Neni 4 Tregu përkatës**

1. Tregu përkatës përcaktohet si:

1.1. treg përkatës i produktit, që domethënë tregu që përfshin të gjitha mallrat ose shërbimet që vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori për arsye të karakteristikave, çmimeve dhe përdorimit të synuar;

1.2. treg përkatës gjeografik, që domethënë tregu që përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaft homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinje.

2. Autoriteti nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e tregut përkatës.

### **KAPITULLI II MARRËVESHJET**

#### **Neni 5 Marrëveshjet e ndaluara (kartelet)**

1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë për qëllim parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës. Ndalohen veçanërisht marrëveshjet që:

1.1. drejtpërdrejt ose tërthorazi caktojnë çmimet e shitblerjes ose çdo kusht tjetër tregtimi;

1.2. kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

1.3. ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

1.4. zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në pozitë të pafavorshme konkurruese;

1.5. kushtëzojnë lidhjen e kontratës me pranimin nga palët kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose përdorimi tregtar nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet për marrëveshjet që tërë kohëzgjatjen e tyre i plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

2.1. kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjes së mallrave ose në promovimin e përparimit teknik ose ekonomik;

2.2. u lejojnë konsumatorëve një pjesë të drejtë të përfitimit;

- 2.3. nuk i imponojnë ndërmarrjes kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e objektivave nga ky paragraf;
- 2.4. nuk i mundësojnë ndërmarrjes të mënjanojë konkurrencën për një pjesë të konsiderueshme të produkteve përkatëse.
3. Ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve që pretendon pajtueshmëri me paragrafin 2 të këtij neni, bartë barrën e provës.
4. Marrëveshjet që ndalohen sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç nëse përjashtohen sipas paragrafit 2 të këtij neni, janë nule.

### **Neni 6** **Përjashtimi grupor**

1. Rregulloret e përjashtimit grupor përcaktojnë përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve nga ndalimi i përgjithshëm sipas paragrafit 1 të nenit 5 të këtij ligji.
2. Autoriteti me akt nënligjor përcakton kategoritë e marrëveshjeve dhe rrethanat në të cilat marrëveshja përmbush kushtet nga paragrafi 2 i nenit 5 të këtij ligji. Autoriteti njofton komisionin përkatës parlamentar pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të nxjerrë aktin nënligjor.
3. Rregulloret e përjashtimit grupor përcaktojnë përjashtimin e këtyre kategorive:
- 3.1. marrëveshjet mes ndërmarrjeve që nuk veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose shpërndarjes -marrëveshje vertikale-, dhe veçanërisht marrëveshjet e shpërndarjes ekskluzive, marrëveshjet e shpërndarjes selektive, marrëveshjet e blerjes ekskluzive dhe ekskluzivitetit;
  - 3.2. marrëveshjet mes ndërmarrjeve që veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose shpërndarjes -marrëveshje horizontale-, dhe veçanërisht marrëveshjet e kërkimit, zhvillimit dhe specializimit;
  - 3.3. marrëveshjet për transferimin e teknologjisë;
  - 3.4. marrëveshjet për shpërndarjen dhe servisimin e automjeteve;
  - 3.5. marrëveshjet e sigurimit;
  - 3.6. marrëveshjet mes ndërmarrjeve në sektorin e transportit.
4. Rregulloret e përjashtimit grupor përcaktojnë në veçanti:
- 4.1. kushtet të cilat marrëveshjet duhet t'i përmbajnë;
  - 4.2. kufizimet ose kushtet që marrëveshjet e tilla nuk duhet t'i përmbajnë.
5. Lejohet përjashtimi grupor vetëm për atë sa efektet e marrëveshjes, individualisht ose bashkë me marrëveshje të ngjashme në tregun përkatës, janë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 5 të këtij ligji.
6. Autoriteti mund të fillojë procedurë sipas detyrës zyrtare për vlerësimin e efekteve të marrëveshjeve që përmbushin kushtet e përjashtimit grupor. Nëse konstaton se efektet e marrëveshjes janë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 5 të këtij ligji, Autoriteti me vendim tërheq marrëveshjen nga përjashtimi grupor.

## Neni 7

### Marrëveshjet me rëndësi të vogël

1. Paragrafi 1 i nenit 5 të këtij ligji nuk zbatohet për marrëveshjet me rëndësi të vogël nëse palët e marrëveshjes dhe ndërmarrjet që ato kontrollojnë kanë bashkë pozitë të parëndësishme në treg dhe pjesëmarrja e tyre e përbashkët në treg nuk tejkalon:

1.1. dhjetë për qind (10%), nëse palët veprojnë në të njëjtin nivel të zinxhirit të prodhimit dhe shpërndarjes -marrëveshje horizontale;

1.2. pesëmbëdhjetë për qind (15%), nëse palët veprojnë në nivele të ndryshme të zinxhirit të prodhimit dhe shpërndarjes- marrëveshje vertikale;

1.3. dhjetë për qind (10%), nëse marrëveshja ka karakteristika të marrëveshjeve horizontale dhe vertikale ose është e vështirë të përcaktohet nëse marrëveshja është vertikale apo horizontale;

1.4. tridhjetë për qind (30%), nëse marrëveshjet mes pjesëmarrësve të ndryshëm kanë efekt të ndjeshëm në treg dhe pjesëmarrja individuale e secilit pjesëmarrës nuk tejkalon pesë për qind (5%) të secilit treg individual ku shfaqen efektet e marrëveshjes.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet për marrëveshjet që kanë për qëllim përcaktimin e çmimeve, kufizimin e prodhimit ose ndarjen e tregut dhe furnizimit.

3. Autoriteti nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e marrëveshjeve me rëndësi të vogël.

## KAPITULLI III POZITA DOMINUESE

### Neni 8

#### Përcaktimi i pozitës dominuese

1. Ka pozitë dominuese ndërmarrja që shkak i fuqisë në treg mund të veprojë në masë të konsiderueshme e pavarur nga konkurrentët aktualë ose potencialë, konsumatorët, blerësit ose furnitorët në tregun përkatës. Ka pozitë dominuese veçanërisht ndërmarrja që:

1.1. nuk ka konkurrentë domethënës në tregun përkatës; ose

1.2. ka fuqi të konsiderueshme në tregun përkatës në krahasim me konkurrentët aktualë ose potencialë, sidomos lidhur me:

1.2.1. pjesëmarrjen dhe pozitën e ndërmarrjes në tregun përkatës;

1.2.2. fuqinë financiare të ndërmarrjes;

1.2.3. qasjen e ndërmarrjes ndaj furnizimeve ose tregjeve;

1.2.4. lidhjet e ndërmarrjes me ndërmarrjet tjera;

1.2.5. pengesat juridike ose faktike për hyrjen e ndërmarrjeve të tjera në treg;

1.2.6. aftësitë për të imponuar kushte të tregut në ofertën ose kërkesën e tij; ose

1.2.7. aftësitë për të përjashtuar konkurrentët nga tregu duke i orientuar në ndërmarrjet e tjera.

2. Përveç nëse vërtetohet ndryshe, konsiderohet se ka pozitë dominuese ndërmarrja me pjesëmarrje prej katërdhjetë për qind (40%) ose më shumë në tregun përkatës. Ndërmarrja mund të dëshmojë se nuk ka pozitë dominuese duke u mbështetur në faktorët nga nënparagrafi 1.2 i këtij neni.

3. Mund të kenë pozitë dominuese ndërmarrjet ekonomike juridikisht të pavarura nëse:

3.1. pjesëmarrja e tyre e përbashkët në treg tejkalon gjashtëdhjetë për qind (60%);

3.2. ndërmarrjet veprojnë në masë të konsiderueshme të pavarur ndaj konkurrentëve, konsumatorëve, blerësve ose furnitorëve; dhe,

3.3. ndërmarrjet paraqiten ose veprojnë bashkë në tregun përkatës.

4. Autoriteti ka barrën e provës së pozitës dominuese të:

4.1. ndërmarrjes me pjesëmarrje individuale nën katërdhjetë për qind (40%) të tregut përkatës;

4.2. grupimit të ndërmarrjeve me pjesëmarrje të përbashkët nën gjashtëdhjetë për qind (60%) të tregut përkatës.

5. Autoriteti nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e pozitës dominuese.

### **Neni 9 Keqpërdorimi i pozitës dominuese**

1. Ndalohet keqpërdorimi i pozitës dominuese.

2. Ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve keqpërdor pozitën dominuese nëse:

2.1. drejtpërdrejt ose tërthorazi vendos çmim të padrejtë të blerjes ose shitjes ose kushte tjera të padrejta tregtare;

2.2. kufizon prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve;

2.3. zbaton kushte të ndryshme për transaksione të barasvlershme me ndërmarrjet e tjera, duke i vënë ato në pozitë të pafavorshme konkurruese;

2.4. kushtëzon lidhjen e kontratës me detyrime shtesë që nga natyra ose përdorimi tregtar nuk kanë lidhje me objektin e kontratës;

2.5. vendos çmime ose kushte të tjera që kanë për qëllim ose rezultat pengimin e hyrjes në tregun përkatës ose nxjerrjen jashtë tregut përkatës të konkurrentëve të veçantë ose të produktit të tyre;

2.6. i refuzon ndërmarrjes tjetër qasje kundrejt shpërblimit të përshtatshëm në rrjet ose infrastrukturë, duke ia pamundësuar të veprojë si konkurrent.

3. Autoriteti nxjerr akt nënligjor për keqpërdorimin e pozitës dominuese.

### **Neni 10 Konstatimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese**

1. Mbështetur në nenet 8 dhe 9 të këtij ligji, Autoriteti me vendim lidhur me keqpërdorimin e pozitës dominuese:

1.1. konstaton ekzistimin e pozitës dominuese, veprimin me të cilin ndërmarrja ose gru-



pimi i ndërmarrjeve shkel konkurrencën në treg, si dhe kohëzgjatjen e veprimit;

1.2. i ndalon ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjeve të vazhdojë veprimin që shkel konkurrencën;

1.3. përcakton masat, kushtet dhe afatet për mënjanimin e efekteve të dëmshme të veprimeve që shkelin konkurrencën;

1.4. shqipton gjobë në pajtim me këtë ligj.

2. Masat nga nënparagrafi 1.3 i këtij neni përfshijnë masën e vëzhgimit të ndërmarrjes dhe masën strukturore. Masa strukturore mund të caktohet vetëm nëse masa e vëzhgimit të ndërmarrjes është e paefektshme ose më e rëndë se masa strukturore.

## KAPITULLI IV PËRQENDRIMET

### Neni 11 Përqendrimi

1. Përqendrimi paraqitet me ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të ndërmarrjeve kur bashkohen ndërmarrje të pavarura ose pjesë të tyre; një a më shumë ndërmarrje fitojnë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tërësisë ose pjesëve të ndërmarrjeve të tjera, sidomos duke fituar aksione; duke fituar shumicën e të drejtave të votimit dhe në mënyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

2. Fitimi i kontrollit sipas paragrafit 1 të këtij neni, realizohet me bartjen e të drejtave, me kontratë ose në mënyrë tjetër që u mundëson ndërmarrjeve që vetë ose bashkë të ushtrojnë në bazë të qëndrueshme ndikim vendimtar mbi ndërmarrje të tjera.

3. Fitimi i kontrollit realizohet sidomos me:

3.1. bartjen e pronësisë ose të drejtës për të përdorur tërësisht ose pjesërisht asetet e ndërmarrjeve;

3.2. bartjen e të drejtave ose me kontrata që sjellin ndikim vendimtar në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve të ndërmarrjeve.

4. Nuk quhen përqendrim i ndërmarrjeve sipas këtij neni, nëse:

4.1. blerja për rishitje e aksioneve të ndërmarrjes nga institucioni financiar, institucioni i kreditit ose institucioni i sigurimit, për aq sa blerësi nuk ushtron të drejtën e votës për aksionet dhe shet aksionet brenda dymbëdhjetë (12) muajve blerësi mund t'i kërkojë Autoritetit afat shtesë prej dymbëdhjetë (12) muajsh, nëse dëshmon se nuk ka mundur të shesë aksionet;

4.2. blerja e aksioneve për shkak të ristrukturimit të brendshëm të ndërmarrjes dhe lidhur me fitimin e kontrollit të përbashkët, bashkimit ose bartjen e pronësisë;

4.3. bartja e kontrollit të ndërmarrjes të administratori falimentues ose likuidatori, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

4.4. krijimi i ndërmarrjes së përbashkët nga ndërmarrje të pavarura që në bazë të qëndrueshme kryejnë të gjitha funksionet si subjekte ekonomike të pavarura, ku njëra ndërmarrje ka për qëllim ose efekt bashkërendimin e sjelljes konkurruese të ndërmarrjeve të tjera dhe bashkërendimi është vlerësuar në përputhje me Kapitullin II të këtij ligji.

5. Autoriteti me akt nënligjor përcakton mënyrën e parashtrimit të kërkesës për lejimin e përqendrimit dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit.

### **Neni 12** **Përqendrimet e ndaluara**

Ndalohen përqendrimet që mund të shtrembërojnë ndjeshëm konkurrencën efektive, veçanërisht nëse përqendrimi i tillë ka si pasojë krijimin ose forcimin e pozitës dominuese.

### **Neni 13** **Detyrimi për të kërkuar lejimin e përqendrimit**

1. Pjesëmarrësit në përqendrim duhet t'i kërkojnë paraprakisht Autoritetit t'ua lejojë realizimin e përqendrimit të synuar nëse:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm; ose

1.2. së paku dy pjesëmarrës në përqendrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm.

2. Qarkullimi i pjesëmarrësve në përqendrim llogaritet sipas raporteve financiare të vitit financiar që i paraprin vitit të përqendrimit. Nëse parashtruesit nuk kanë arritur të mbyllin raportet financiare vjetore para se të parashtrojnë kërkesën për lejimin e përqendrimit, qarkullimi i pjesëmarrësve llogaritet sipas raporteve financiare të vitit të fundit financiar për të cilin janë mbyllur raportet financiare.

3. Nëse pjesëmarrësi i përqendrimit i përket një grupi ndërmarrjesh të lidhura, për qarkullim merren të ardhurat e të gjitha ndërmarrjeve të grupit. Nuk merren parasysh të hyrat nga shitja e mallrave ose shërbimeve brenda grupit.

4. Nëse përqendrimi ka të bëjë me blerjen e pjeseshme të ndërmarrjes sipas paragrafit 1 të nenit 11 të këtij ligji, merret parasysh vetëm qarkullimi i pjesëve që janë objekt i përqendrimit.

5. Trajtohen si një përqendrim marrëveshjet nga paragrafi 4 i këtij neni që lidhen brenda një periudhe dyvjeçare mes ndërmarrjeve të njëjta. Përqendrimi lind në datën e transaksionit të fundit.

6. Autoriteti shqyrton kërkesat për lejimin e përqendrimit vetëm kur parashtrohen në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

### **Neni 14** **Përqendrimi i institucioneve financiare**

1. Nëse pjesëmarrësi në përqendrim është institucion financiar, për qarkullim nga neni 13 i këtij ligji merren të hyrat e përgjithshme nga aktivitetet operative të vitit financiar që i paraprin vitit të përqendrimit. Institucioni financiar përfshin shoqërinë e sigurimit dhe risigurimit.

2. Të hyrat e institucionit financiar përcaktohen pas zbritjes së tatimeve që lidhen drejtpërdrejt me elementet e mëposhtme:

2.1. të hyrat nga interesi;

2.2. të hyrat nga aksionet, nga letra me vlerë me normë interesi të ndryshueshme, si dhe nga interesat e pjesëmarrjeve në kapital;

- 2.3. të hyrat nga komisionet e arkëtueshme;
  - 2.4. fitimi neto nga operacionet financiare;
  - 2.5. të hyra nga aktivitetet e tjera.
3. Të hyrat e shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit përcaktohen nga vlera bruto e primeve të nënshkuara, që përfshijnë shumat e marra dhe të arkëtueshme sipas kontratave të sigurimit të lëshuara nga shoqëria ose në emër të saj, duke përfshirë primet e risigurimit, pas zbritjes së tatimeve sipas paragrafit 2 të këtij neni.
4. Pjesëmarrja në treg sipas përqindjes për pjesëmarrësit në përqendrim - institucionet financiare, llogaritet duke u bazuar në gjithsej asetet e pjesëmarrësve në përqendrim - institucioneve financiare.

#### **Neni 15**

##### **Parashtrimi i kërkesës për lejimin e përqendrimit**

1. Kërkesën për lejimin e përqendrimit e parashtron ndërmarrja që fiton kontrollin në ndërmarrjen tjetër. Në rastet e tjera, kërkesën e parashtronjë të gjithë pjesëmarrësit në përqendrim, sipas marrëveshjes së përbashkët.
2. Kërkesa për lejimin e përqendrimit parashtrohet pas lidhjes së kontratës me të cilën fitohet kontrolli i ndërmarrjes ose pas bërjes publike të përqendrimit dhe para realizimit të përqendrimit.
3. Pjesëmarrësit në përqendrim mund të parashtronjë kërkesë për lejimin e përqendrimit para lidhjes së kontratës ose bërjes publike të përqendrimit, nëse dëshmojnë se do të lidhet kontrata ose do të bëhet publik përqendrimi.
4. Përqendrimi mund të realizohet pasi të kalojë afati nga neni 18 i këtij ligji.
5. Me kërkesën e pjesëmarrësve, për shkaqe të arsyeshme, Autoriteti mund të lejojë veprime të caktuara për realizimin e përqendrimit para afatit.
6. Në shqyrtimin e kërkesës për lejimin e përqendrimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, sidomos natyrën dhe peshën e dëmit që mund t'u shkaktohet pjesëmarrësve në përqendrim ose palëve të treta, si dhe efektet e konkurrencës që mund të lindin nga realizimi i përqendrimit.

#### **Neni 16**

##### **Përmbajtja e kërkesës për lejimin e përqendrimit**

1. Kërkesës për lejimin e përqendrimit i bashkëngjiten:
  - 1.1. kontrata ose dokumenti tjetër që dëfton bazën juridike të përqendrimit, në origjinal ose kopje të vërtetuar dhe me përkthim të vërtetuar në gjuhën zyrtare;
  - 1.2. raporti vjetor financiar i pjesëmarrësve në përqendrimin për vitin paraprak financiar;
  - 1.3. dokumentet dhe të dhënat e tjera të parapara me aktin nënligjor nga paragrafi 4 i nenit 11 të këtij ligji.
2. Autoriteti mund ta lirojë parashtruesin nga dorëzimi i dokumenteve ose i të dhënave nga nënparagrafi 1.3 i këtij neni, nëse parashtruesi dëshmon se dokumentet ose të dhënat nuk janë të domosdoshme.
3. Parashtruesi i kërkesës për lejimin e përqendrimit duhet të cekë nëse ka detyrim të njoftojë

organin e një shteti tjetër për vlerësimin e përqendrimit ose se njoftimi i tillë është parashtruar.

4. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, parashtrohet kërkesë e shkurtër për lejimin e përqendrimit në rastet kur Autoriteti zhvillon procedurë të shkurtër të vlerësimit të përqendrimit. Procedura e shkurtër zhvillohet veçanërisht në këto raste:

4.1. pjesëmarrësit në përqendrim nuk veprojnë në tregun e njëjtë përkatës gjeografik dhe të produktit dhe mes pjesëmarrësve nuk ka marrëveshje horizontale;

4.2. asnjëri pjesëmarrës në përqendrim nuk vepron në treg në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të tregut në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër dhe mes pjesëmarrësve nuk ka marrëveshje vertikale;

4.3. pjesëmarrësit në përqendrim veprojnë në të njëjtin treg përkatës gjeografik dhe të produktit, por aksionet e tyre të përbashkëta nuk kalojnë pesëmbëdhjetë për qind (15%) të tregut përkatës;

4.4. pjesëmarrësi në përqendrim vepron në treg në rrjedhën e sipërme ose të poshtme të tregut në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër dhe mes pjesëmarrësve ka marrëdhënie vertikale, por aksionet e tyre të përbashkëta nuk i kalojnë njëzetepesë për qind (25%) në secilin nivel të tregut;

4.5. pjesëmarrësi i përqendrimit fiton i vetëm kontrollin e ndërmarrjes mbi të cilën tashmë ka kontroll të përbashkët;

4.6. ndërmarrjet fitojnë kontroll të ndërmarrjes së përbashkët, e cila nuk kryen dhe nuk pritet të kryejë veprimtari brenda një kohe të arsyeshme në Republikën e Kosovës.

5. Autoriteti mund të refuzojë procedurën e shkurtër nga paragrafi 4 i këtij neni dhe të urdhërojë parashtrimin e kërkesës së plotë sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse ka indikacione se përqendrimi i synuar mund ta pengojë dukshëm konkurrencën efektive.

6. Kërkesa e plotë për lejimin e përqendrimit quhet e parashtruar në ditën kur Autoriteti pranon të gjitha dokumentet dhe të dhënat nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni. Autoriteti i lëshon parashtruesit vërtetim për parashtrimin e kërkesës.

#### **Neni 17**

#### **Procedura e vlerësimit të përqendrimit**

1. Autoriteti fillon procedurën e vlerësimit të përqendrimit pasi pranon kërkesën e plotë sipas paragrafit 6 të nenit 16 të këtij ligji.

2. Parashtruesi i kërkesës për lejimin e përqendrimit ka barrën e provës së efekteve të dobishme të përqendrimit. Autoriteti mund t'i kërkojë parashtruesit të dorëzojë dokumente dhe të dhëna të nevojshme për vlerësimin e përqendrimit.

3. Në përputhje me nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 29 të këtij ligji, Autoriteti publikon ne ueb-faqen e vet njoftim publik për përqendrimin e synuar. Njoftimi publik përfshin:

3.1. emrat e pjesëmarrësve në përqendrim dhe llojin e veprimtarive që kryejnë pjesëmarrësit në përqendrim në Republikën e Kosovës;

3.2. natyrën e përqendrimit;

3.3. thirrjen drejtuar ndërmarrjeve, shoqatave profesionale, shoqatave të punëdhënësve, shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe personave të tjerë që nuk janë palë në procedurë, përkatësisht konkurrentëve të pjesëmarrësve në përqendrim, për të cilët

pandehet se kanë njohuri për raportet e tregjeve përkatëse, për të dhënë vërejtje, qëndrime dhe mendime rreth efekteve të mundshme të përqendrimit;

3.4. afatin për parashtrimin e vërejtjeve, qëndrimeve dhe mendimeve, që nuk mund të jetë më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

4. Nëse gjatë vlerësimit të përqendrimit, ndërmarrja që fiton kontrollin parashtron kërkesë të re për lejimin e përqendrimit, Autoriteti mund të zhvillojë procedurë të bashkuar për kërkesat nëse e çmon të përshtatshme dhe ekonomike.

5. Afati për vlerësimin e përqendrimit rrjedh nga lëshimi i vërtetimit të parashtrimit të kërkesës për lejimin e përqendrimit sipas paragrafit 6 të nenit 16 të këtij ligji.

6. Autoriteti me akt nënligjor përcakton mënyrën e vlerësimit të përqendrimit.

### **Neni 18**

#### **Vërtetimi dhe vendimi për lejimin e përqendrimit**

1. Përqendrimi quhet i lejuar nëse Autoriteti:

1.1. mbështetur në dokumentet dhe të dhënat e dorëzuara nga parashtruesi ose në njohuritë që zotëron, çmon se përqendrimi i synuar nuk ndalohet me nenin 12 të këtij ligji; dhe

1.2. nuk nxjerr konkluzion për fillimin e procedurës së vlerësimit të përqendrimit brenda tridhjetë (30) ditëve pasi pranon kërkesën e plotë për lejimin e përqendrimit.

2. Pjesëmarrësi i përqendrimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i kërkojë Autoritetit vërtetim për lejimin e përqendrimit. Autoriteti lëshon vërtetimin brenda shtatë (7) ditëve.

3. Autoriteti nxjerr konkluzion për fillimin e procedurës së vlerësimit të përqendrimit nëse çmon se përqendrimi mund të pengojë konkurrencën efektive në tregun përkatës, sidomos me krijimin ose forcimin e pozitës dominuese. Konkluzioni mbështetet në dokumentet dhe të dhënat e dorëzuara nga parashtruesi dhe në njohuritë që zotëron Autoriteti.

4. Gjatë procedurës së vlerësimit të përqendrimit, Autoriteti njofton pa vonesë parashtruesin e kërkesës për lejimin e përqendrimit kur konstaton se përqendrimi mund të lejohet vetëm me caktimin e masave, kushteve dhe afateve për mënjanimin e efekteve të dëmshme të përqendrimit. Parashtruesi ka tridhjetë (30) ditë afat për të propozuar masa, kushte dhe afate të përshtatshme.

5. Masat, kushtet dhe afatet nga paragrafi 4 i këtij neni mund të propozohen më herët, qoftë edhe në kërkesën fillestare për lejimin e përqendrimit.

6. Autoriteti mund të miratojë tërësisht ose pjesërisht masat, kushtet dhe afatet e propozuara, nëse konstaton se janë të mjaftueshme për të parandaluar pengimin e konkurrencës efektive në tregun përkatës.

7. Nëse Autoriteti nuk miraton masat, kushtet dhe afatet e propozuara, Autoriteti mund t'i caktojë ato vetë.

8. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas konkluzionit për fillimin e procedurës sipas paragrafit 3 të këtij neni, Autoriteti me vendim:

8.1. shpall përqendrimin të lejuar;

8.2. shpall përqendrimin të lejuar nëse zbatohen masat, kushtet dhe afatet e miratuara ose të caktuara nga Autoriteti; ose

8.3. shpall përqendrimin të ndaluar.

9. Në rastin nga nën-paragrafi 8.2 i këtij neni, pjesëmarrësit në përqendrim mund të fillojnë realizimin nga data e vendimit.

10. Nëse pjesëmarrësit në përqendrim nuk zbatojnë masat ose kushtet brenda afateve të caktuara me vendim, Autoriteti shfuqizon ose ndryshon vendimin sipas nenit 19 të këtij ligji.

11. Afati nga paragrafi 8 i këtij neni pezullohet nëse pjesëmarrësi në përqendrim nuk dorëzon të plota dokumentet dhe të dhënat e kërkuara nga Autoriteti sipas paragrafit 2 të nenit 17 të këtij ligji. Afati pezullohet nga dita e parë e punës pasi skadon afati i dorëzimit deri në dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave.

### **Neni 19**

#### **Shfuqizimi dhe ndryshimi i vendimit për lejimin e përqendrimit**

1. Sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të pjesëmarrësit në përqendrim, Autoriteti mund ta shfuqizojë vendimin për lejimin e përqendrimit kur:

1.1. pjesëmarrësi në përqendrim ka dhënë informata të pasakta ose të rrejshme lidhur me faktet vendimtare; ose

1.2. pjesëmarrësi në përqendrim nuk zbaton masat ose kushtet brenda afateve të caktuara me vendimin e Autoritetit.

2. Në rastet nga nënparagrafi 1.1 i këtij neni, Autoriteti shfuqizon vendimin në përputhje me nenin 12 të këtij ligji dhe cakton masa, kushte dhe afate për rivendosjen e konkurrencës efektive në treg.

3. Sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të pjesëmarrësit në përqendrim, Autoriteti mund të ndryshojë vendimin për lejimin e përqendrimit, nëse pjesëmarrësi në përqendrim nuk mund të zbatojë masat ose kushtet brenda afateve të caktuara për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe të pashmangshme jashtë kontrollit të tij. Vendimi i ndryshuar cakton masa, kushte dhe afate të reja.

### **Neni 20**

#### **Masat pas realizimit të paligjshëm të përqendrimit**

1. Autoriteti sipas detyrës zyrtare cakton me vendim masat, kushtet dhe afatet për rivendosjen e konkurrencës efektive në tregun përkatës kur përqendrimi realizohet:

1.1. në kundërshtim me vendimin e Autoritetit që shpall përqendrimin të ndaluar, sipas nën paragrafit 8.3 të nenit 18 të këtij ligji;

1.2. pa u parashtruar kërkesa për lejimin e përqendrimit sipas nenit 15 të këtij ligji.

2. Masat e caktuara me paragrafin 1 të këtij neni mund të jenë masa të sjelljes ose masa strukturore.

3. Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti mund:

3.1. të urdhërojë shitjen ose bartjen e aksioneve të fituara;

3.2. të ndalojë ose të kufizojë ushtrimin e të drejtave të votimit në ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim;

3.3. të urdhërojë ndërprerjen e ndërmarrjes së përbashkët;

3.4. të ndalojë forma të tjera të fitimit të kontrollit sipas nenit 11 të këtij ligji që çojnë në përqendrim të paligjshëm;

3.5. të shqiptojë gjobë në përputhje me këtë ligj.

## **KAPITULLI V AUTORITETI**

### **Neni 21 Autoriteti**

1. Autoriteti është agjenci e pavarur, që për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Selia e Autoritetit është në Prishtinë.
3. Ndalohet çdo ndërhyrje, politike, publike ose private që mund të cenojë pavarësinë ose paanshmërinë e Autoritetit.
4. Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit rregullohen me këtë ligj dhe me statutin e miratuar nga Komisioni.
5. Nga buxheti i shtetit ndahen mjete të mjaftueshme për nevojat e Autoritetit, duke përfshirë punësimin e profesionistëve të kualifikuar dhe blerjen e mallrave e shërbimeve të domosdoshme për punë.
6. Taksat administrative dhe gjobat që arkëton Autoriteti derdhen në buxhetin e shtetit.

### **Neni 22 Komisioni**

1. Komisioni është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit.
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë, duke përfshirë Kryetarin dhe Nënkryetarin e Autoritetit, të cilët i emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës.
3. Qeveria, pas zhvillimit të konkursit publik, ia propozon Kuvendit Komisionin e ri, gjashtë (6) muaj para përfundimit të mandatit të Komisionit ose menjëherë pasi pozita e anëtarit të Komisionit mbetet e zbrazët.
4. Mandati i anëtarit të Komisionit zgjat pesë (5) vjet.
5. Anëtari i Komisionit mund të riemërohet vetëm një herë.

### **Neni 23 Kushtet për të qenë anëtar i Komisionit**

1. Kushtet për të qenë anëtar i Komisionit, emërohet personi i cili duhet:
  - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. të ketë kualifikim të lartë në drejtësi, ekonomi ose drejtim të barasvlershëm; dhe,
  - 1.3. të ketë pesë (5) vjet përvojë pune profesionale.
2. Askush nuk mund të emërohet anëtar i Komisionit nëse:

- 2.1. brenda dy (2) viteve të fundit ka qenë anëtar i bordit drejtues ose menaxhues të një ndërmarrjeje ose grupimi të ndërmarrjeve;
  - 2.2. në pesë (5) vitet e fundit është dënuar me vendim të prerë për veprat penale: të korrupsionit zyrtar; keqpërdorim i detyrës zyrtare; krime ekonomike dhe konflikt të interesit.
3. Gjatë ushtrimit të mandatit, anëtari i Komisionit nuk mund:
- 3.1. të ketë interes pronësor, marrëdhënie pune ose marrëdhënie kontraktuese me një ndërmarrje ose grupim të ndërmarrjeve;
  - 3.2. të jetë zyrtar publik;
  - 3.3. të përfshihet në veprimtari politike.

#### **Neni 24**

##### **Shkarkimi i anëtarit të Komisionit**

1. Kuvendi apo Qeveria propozon shkarkimin e anëtarit të Komisionit nëse:
  - 1.1. nuk është në gjendje shëndetësore të kryejë detyrat për mbi tre (3) muaj dhe nuk ofron dëshmi mjekësore se do të jetë në gjendje të kryejë detyrat gjatë tre (3) muajve vijues;
  - 1.2. shkel nenin 23 të këtij ligji;
  - 1.3. përfshihet në konflikt interesi në kundërshtim me nenin 31 të këtij ligji ose me legjislacionin tjetër në fuqi; ose
  - 1.4. shpërfill rëndë detyrën e anëtarit të Komisionit.
2. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, anëtari i Komisionit shkarkohet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve.

#### **Neni 25**

##### **Kryetari i Autoritetit**

1. Kryetari është udhëheqësi i Autoritetit dhe i ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. përfaqëson Autoritetin;
  - 1.2. organizon dhe drejton veprimtarinë e Autoritetit;
  - 1.3. përgatit, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Komisionit dhe bashkërendon punën mes anëtarëve të Komisionit;
  - 1.4. nënshkruan aktet e Komisionit, me përjashtim të vendimeve që nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje;
  - 1.5. i propozon Komisionit emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin dhe aktet e tjera të Autoritetit;
  - 1.6. përgjigjet për punën profesionale të Autoritetit.
2. Në rast mungese, Kryetarin e zëvendëson Nënkryetari ose i autorizuari i Komisionit.



## **Neni 26** **Përgjegjësitë e Komisionit**

1. Komisioni ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. harton dhe miraton akte nënligjore në përputhje me këtë ligj;
  - 1.2. vendos për fillimin e procedurës për hetimin e çrregullimit të konkurrencës;
  - 1.3. shqipton gjopa për shkelje të këtij ligji;
  - 1.4. nxjerr vendim për lejimin e përqendrimit;
  - 1.5. përcakton kushte, masa dhe afate për realizimin e përqendrimit;
  - 1.6. përmbyll procedurat dhe cakton masat, kushtet dhe afatet për rivendosjen e konkurrencës efektive të tregut;
  - 1.7. i kërkon gjykatës të autorizojë kontrollin e paparalajmëruar sipas neneve 40, 41, 42, 43 dhe 44 të këtij ligji;
  - 1.8. informon dhe ndërgjegjëson publikun për konkurrencën në treg;
  - 1.9. përcakton parimet metodologjike për hetimin e konkurrencës së tregut;
  - 1.10. përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës;
  - 1.11. jep mendime profesionale dhe rekomandime sipas nenit 32 të këtij ligji;
  - 1.12. bashkëpunon me institucionet simotra lidhur me fushëveprimin e Autoritetit, të përcaktuar me këtë ligj dhe me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës;
  - 1.13. miraton raportin vjetor të punës së Autoritetit dhe ia paraqet Kuvendit të Republikës deri më 31 mars të vitit vijues;
  - 1.14. kryen studime të tregut dhe mbledh të dhëna sipas këtij ligji.
2. Komisioni cakton përparësitë për zbatim duke u mbështetur në ndjeshmërinë dhe rëndësinë e rasteve.

## **Neni 27** **Mbledhjet dhe vendimmarrja e Komisionit**

1. Komisioni ka kuorum për vendimmarrje kur janë së paku tre (3) anëtarë në mbledhje.
2. Komisioni merr vendim kur së paku tre (3) anëtarë votojnë "për".
3. Anëtari që voton kundër, mund të jap arsye më shkrim për votën "kundër".
4. Anëtari i Komisionit nuk mund të abstenojë, por mund të përjashtohet sipas nenit 53 të këtij ligji.
5. Anëtari i Komisionit duhet të silllet në atë mënyrë që nuk cenon reputacionin e Autoritetit gjatë vendimmarrjes.

### **Neni 28 Sekretariati**

1. Organizmi dhe funksionimi i Sekretariatit përcaktohet me këtë ligj, me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligjin për Zyrarët Publikë dhe me statutin e Autoritetit.
2. Sekretariati drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Nëpunësit e Sekretariatit kanë statusin e nëpunësit civil.
4. Sekretariati kryen hetime administrative sipas këtij ligji, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
5. Pagat, shtesa e rrezikshmërisë dhe shtesat e tjera të nëpunësit të Sekretariatit mbështeten në kushtet e veçanta të punës dhe paguhen sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 29 Përgjegjësitë e Sekretariatit**

1. Për zbatimin e këtij ligji, Sekretariati ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. monitoron dhe analizon kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive;
  - 1.2. kryen hetime në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi;
  - 1.3. harton raportet e hetimit dhe ia paraqet Komisionit për vendimmarrje;
  - 1.4. siguron botimin e vendimeve dhe akteve të tjera të botueshme, të akteve nënligjore të miratuara sipas këtij ligji, si dhe të raportit vjetor të punës së Autoritetit;
  - 1.5. kujdeset për zbatimin e vendimeve të Komisionit;
  - 1.6. kryen punë të tjera të parapara me statutin e Autoritetit.

### **Neni 30 Drejtori i Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm për punën e tij dhe të Sekretariatit i përgjigjet Komisionit.
2. Drejtori i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi:
  - 2.1. siguron zhvillimin e procedurave dhe lëndëve sipas këtij ligji;
  - 2.2. siguron hartimin dhe paraqitjen e raportit të hetimit për vendimmarrje në Komision;
  - 2.3. bashkërendon punën e Sekretariatit;
  - 2.4. harton raportin vjetor të punës së Autoritetit.

**Neni 31****Parandalimi i konfliktit të interesit**

1. Zyrtari i Autoritetit mund të jetë anëtar ose pjesëmarrës në institut shkencor ose shoqatë tjetër që nuk cenon paanshmërinë e zyrtarit në kryerjen e detyrës.
2. Zyrtari i Autoritetit nuk mund të jetë anëtar i bordit drejtues ose administratës së ndërmarrjes ose shoqatës apo grupit të interesit, që mund të cenojë paanshmërinë e zyrtarit në kryerjen e detyrës. Si dhe në rastet tjera që bie ndesh me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

**KAPITULLI VI****MENDIMI PROFESIONAL DHE REKOMANDIMET****Neni 32****Mendimi profesional dhe rekomandimet e Autoritetit**

1. Me vet-nismë ose rekomandim të Kuvendit të Republikës, Qeverisë ose organit publik, Autoriteti jep mendim profesional për:
  - 1.1. projektligje ose projekt-akte nënligjore që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut;
  - 1.2. pajtueshmërinë me këtë ligj të ligjeve dhe akteve të tjera juridike.
2. Me vetë-nismë ose kërkesë të organit nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti mund t'i japë organit rekomandim për mbrojtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
3. Autoriteti mund të japë mendim profesional ose të publikojë kumtesë për të informuar dhe për të ndërgjegjësuar publikun për konkurrencën në treg, duke përfshirë legjislacionin, politikat dhe zhvillimet krahasuese.

**KAPITULLI VII**  
**PROCEDURAT****Neni 33****Rregullat e procedurës në përgjithësi**

Autoriteti zhvillon procedurën në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Në mungesë të dispozitave të përcaktuara me këtë ligj vlejnë dispozitat e ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Neni 34****Palët në procedurë**

1. Palë në procedurë janë ndërmarrja ndaj të cilës zhvillohet procedura dhe ndërmarrja pjesëmarrëse në përqendrim.
2. Palë në procedurë nuk është propozuesi i fillimit të procedurës, përveç nëse procedura prek të drejtat ose interesat e propozuesit.
3. Personi i cili nuk është palë në procedurë dëshmon se procedura ia prek të drejtat ose interesat, mund t'i kërkojë Autoritetit t'ia njohë të drejtat e propozuesit të fillimit të procedurës nga paragrafi 4 i nenit 35 të këtij ligji. Lidhur me këtë Autoriteti vendos me konkluzion brenda tridhjetë (30) ditëve.

### **Neni 35**

#### **Propozimi për fillimin e procedurës**

1. Propozimin për fillimin e procedurës në kompetencë të Autoritetit mund ta parashtrojë çdo person fizik apo juridik, shoqatë profesionale, shoqatë e ndërmarrjeve, shoqatë e konsumatorëve, Qeveria ose organi i administratës publike qendrore ose lokale.
2. Propozimi për fillimin e procedurës përmban:
  - 2.1. emrin dhe selinë e propozuesit, nëse është personi juridik, ose emrin, mbiemrin dhe vendqendrimin e propozuesit, nëse është person fizik;
  - 2.2. të dhënat përkatëse me të cilat kuptohet se kundër kujt është paraqitur propozimi;
  - 2.3. përshkrimin e fakteve ose rrethanave që janë shkas për propozimin;
  - 2.4. të dhënat personale, dokumentet dhe të dhëna të tjera që zotëron propozuesi dhe që plotësojnë përshkrimin nga nënparagrafi 2.3 i këtij neni.
3. Nëse propozimi përmban informata që propozuesi i konsideron fshehtësi tregtare, propozuesi duhet t'i saktësojë ato dhe t'i arsyetojë juridikisht.
4. Me kërkesën e propozuesit, Autoriteti:
  - 4.1. njofton propozuesin për konstatimin paraprak të fakteve në formë të shkurtër sipas nenit 46 të këtij ligji;
  - 4.2. fton propozuesin si dëshmitar në seancë dëgjimore.
5. Propozuesi mund t'i kërkojë Autoritetit mbrojtjen e identitetit. Autoriteti miraton kërkesën me arsye, por nuk i jep propozuesit të drejtat nga paragrafi 4 i këtij neni.

### **Neni 36**

#### **Fillimi i procedurës**

1. Autoriteti fillon sipas detyrës zyrtare:
  - 1.1. procedurën për konstatimin e marrëveshjes së ndaluar nga neni 5 i këtij ligji;
  - 1.2. procedurën për konstatimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese nga neni 9 i këtij ligji.
2. Autoriteti fillon procedurën për vlerësimin e përqendrimit me kërkesën e pjesëmarrësve sipas nenit 15 të këtij ligji.
3. Autoriteti mund të fillojë procedurën për vlerësimin e përqendrimit sipas detyrës zyrtare nëse:
  - 3.1. pjesëmarrësit në përqendrim nuk parashtrojnë kërkesë për lejimin e përqendrimit sipas nenit 13 të këtij ligji;
  - 3.2. duhet të shfuqizohet ose të ndryshohet vendimi për lejimin e përqendrimit sipas nenit 19 të këtij ligji;
  - 3.3. duhet të caktohen masa pas realizimit të paligjshëm të përqendrimit sipas nenit 20 të këtij ligji.
4. Procedura nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni quhet e filluar ditën që Autoriteti nxjerr kon-

kluzion për fillimin e procedurës sipas nenit 37 të këtij ligji.

5. Nëse çmon se propozimi për fillimin e procedurës ka të bëjë me veprime që nuk kanë efekt të ndjeshëm në konkurrencën e tregut përkatës, Autoriteti me konkluzion konstaton se nuk ka interes publik për të filluar procedurën. Autoriteti ia dorëzon konkluzionin propozuesit.

6. Me të pranuar propozimin për fillimin e procedurës, Autoriteti menjëherë zhvillon shqyrtim paraprak në tregun përkatës sipas nënparagrafëve 1.1 dhe 1.2 të nenit 29 të këtij ligji. Gjatë shqyrtimit paraprak, Autoriteti me konkluzion mund të konstatojë se nuk ka kushte për të filluar procedurën. Autoriteti nxjerr konkluzionin brenda gjashtë (6) muajve nga propozimi.

7. Konkluzionet nga paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni, Autoriteti ia dorëzon konkluzionin propozuesit, me arsyetimin përkatës për secilin pretendim.

8. Gjatë shqyrtimit paraprak nga paragrafi 6 i këtij neni, Autoriteti vepron sipas nenit 39 të këtij ligji.

### **Neni 37**

#### **Konkluzioni për fillimin e procedurës**

1. Konkluzioni për fillimin e procedurës sipas këtij ligji përmban në veçanti:

1.1. numrin e lëndës;

1.2. dispozitat e këtij ligji në bazë të të cilave fillon procedura;

1.3. përshkrimin e fakteve, rrethanave dhe praktikave që janë shkak për fillimin e procedurës;

1.4. kërkesën për dorëzimin e të dhënave dhe dokumenteve sipas nenit 39 të këtij ligji.

### **Neni 38**

#### **Njoftimi, të drejtat dhe detyrimet e palës**

1. Autoriteti ia dorëzon konkluzionin për fillimin e procedurës palës kundër të cilës ka filluar procedura dhe parashtruesit të kërkesës për lejimin e përqendrimit. Në konkluzionin e dorëzuar, mbulohet ose hiqet pjesa që përmban fshehtësi tregtare sipas nenit 51 të këtij ligji.

2. Pala kundër të cilës ka filluar procedura parashtron vërejtjet, informatat dhe dokumentet për lëndën brenda afatit të caktuar nga Autoriteti.

3. Autoriteti cakton afatin nga paragrafi 2 i këtij neni për secilin rast veç e veç. Afati fillestar nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë. Me kërkesën e palës dhe për shkaqe të arsyeshme, Autoriteti mund të shtyjë afatin deri në tridhjetë (30) ditë shtesë.

4. Nëse pala kundër të cilës ka filluar procedura nuk vepron sipas kërkesës dhe brenda afatit të caktuar nuk njofton Autoritetin se nuk është në gjendje të veprojë, Autoriteti konstaton faktet dhe rrethanat sipas detyrës zyrtare, mbështetur në njohuritë e veta, të dhënat dhe dokumentet që zotëron. Autoriteti pa vonesë i dorëzon palës njoftim për konstatimin paraprak të fakteve sipas nenit 46 të këtij ligji dhe pastaj cakton seancë dëgjimore.

5. Nëse procedura fillon sipas propozimit nga neni 35 të këtij ligji, Autoriteti nuk ia dorëzon propozuesit konkluzionin nga paragrafi 1 i këtij neni, por e njofton me shkrim për fillimin e procedurës.

### **Neni 39** **Mbledhja e të dhënave**

1. Autoriteti mund të kërkojë:

1.1. nga palët në procedurë dhe personat e tjerë fizikë e juridikë, shoqatat e ndërmarrjeve, shoqatat e konsumatorëve, organet publike informatat e nevojshme në çfarëdo forme digjitale, vërejtjet me shkrim ose deklaratat me gojë, si dhe ofrimin në shikimin të të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme;

1.2. nga palët në procedurë të mundësojnë shikim të drejtpërdrejtë në të gjitha lokalet afariste, pronat e paluajtshme dhe të luajtshme, librat afaristë, bazat e të dhënave, si dhe dokumentet e tjera dhe informatat e qasshme për ndërmarrjen në çfarëdo forme digjitale, pavarësisht formës dhe mjetit në të cilin është ruajtur;

1.3. nga palët në procedurë kryerjen e veprimeve të tjera që i çmon të nevojshme për konstatimin e fakteve përkatëse.

2. Autoriteti mund të mbledhë dhe të përdorë informatat e dorëzuara vullnetarisht në çfarëdo forme, pavarësisht formës dhe mjetit në të cilin janë ruajtur.

3. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:

3.1. bazën ligjore;

3.2. lëndën dhe qëllimin e kërkesës;

3.3. afatin për përgjigje;

3.4. paralajmërimin ndaj pranuesit se nëse nuk vepron sipas kërkesës do t'i shqiptohet gjobë.

4. Nëse pranuesi nuk vepron sipas kërkesës, Autoriteti me vendim konstaton shkeljen e këtij ligji dhe shqipton gjobë sipas këtij ligji.

5. Nëse pranuesi i kërkesës konsideron fshehtësi tregtare të dhënat ose dokumentet e kërkuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, pranuesi duhet:

5.1. të saktësojë të dhënat dhe dokumentet që i konsideron të tilla dhe të shpjegojë arsyet sipas nenit 51 të këtij ligji;

5.2. t'i dorëzojë Autoritetit pjesën ose tërësinë e të dhënave dhe dokumenteve që nuk përmban fshehtësi tregtare.

6. Nëse pranuesi i kërkesës nuk përgjigjet as pas kërkesës së përsëritur, Autoriteti konstaton se të dhënat dhe dokumentet e kërkuara nuk përbëjnë fshehtësi tregtare.

7. Nëse pranuesi i kërkesës nuk dorëzon të dhënat ose dokumentet e kërkuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, Autoriteti vlerëson rëndësinë e mosdorëzimit dhe konstaton faktet në përputhje me këtë vlerësim.

### **Neni 40** **Kontrolli i paparalajmëruar në objektet e palës**

1. Autoriteti mund të kontrollojë pa paralajmërim objektet e ndërmarrjes ose personit tjetër që i nënshtrohet hetimit, nëse ekziston rreziku i fshehjes ose shkatërrimit të provave.

2. Para se të kryejë kontrollin e paparalajmëruar, Autoriteti i kërkon gjykatës të autorizojë zyrtarët e Autoritetit të hyjnë pa paralajmërim ose leje të veçantë në objektin ku do të kryhet kontrolli.
3. Nëse ekziston dyshim i bazuar se mund të zhduken ose të ndryshohen provat në zotërim të palës në procedurë, zyrtarët e autorizuar të Autoritetit vetë ose me ndihmën e ekspertëve të autorizuar të Policisë kryejnë kontrollin e paparalajmëruar dhe njoftojnë personin në zotërim të objektit ose sendeve.
4. Para se të kryejnë kontrollin e paparalajmëruar, zyrtarët e autorizuar të Autoritetit i dëftojnë palës në procedurë ose zotëruesit të objektit legjitimacionin zyrtar dhe autorizimin nga gjykata për kryerjen e kontrollit.
5. Autoriteti me akt nënligjor rregullon formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit.
6. Nëse në kontroll marrin pjesë persona të tjerë të autorizuar sipas paragrafit 3 të këtij neni, ata i dëftojnë palës në procedurë ose zotëruesit të objektit autorizimin e Autoritetit për bashkë-pjesëmarrje në kontroll.
7. Zyrtarët e autorizuar për kontrollin e paparalajmëruar sipas paragrafit 3 të këtij neni mund:
  - 7.1. të kryejnë kontrole në të gjitha objektet afariste, depot e hapura dhe mjete të transportit në selinë e ndërmarrjes ndaj të cilës zhvillohet procedura dhe në çdo adresë tjetër në të cilën vepron ndërmarrja;
  - 7.2. të shikojnë librat afariste dhe dokumentet e tjera të cilat kanë të bëjnë me afarizmin e ndërmarrjes;
  - 7.3. të marrin ose të kopjojnë librat afariste, ekstraktet nga librat afariste, të dhënat dhe dokumentet e tjera dhe çdo informatë të qasshme për ndërmarrjen, duke përfshirë të dhënat e siguruara në mënyrë ligjore, pavarësisht formës dhe mjetit në të cilin janë ruajtur;
  - 7.4. të marrin dokumentacionin e nevojshëm për të bërë kopjen e dokumenteve;
  - 7.5. të vulosin me plumb mjediset, objektin, librat afariste dhe dokumentet gjatë kohës së kontrollit dhe për aq sa është e domosdoshme për kryerjen e kontrollit;
  - 7.6. të kërkojnë nga përfaqësuesit dhe punëtorët e ndërmarrjes deklaratë me gojë për faktet ose dokumentet që kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontrollit, ndërsa deklaratat e marra të evidentohen;
  - 7.7. të kërkojnë nga përfaqësuesit dhe punëtorët e ndërmarrjeve të parashtrajnë me shkrim vërejtjet për faktet ose dokumentet që kanë të bëjnë me objektin e kontrollit, si dhe të përcaktojnë afatin e nevojshëm për parashtrimin e vërejtjeve.
8. Nëse për arsye teknike nuk mund të bëhen kopje të dokumenteve të nevojshme gjatë kontrollit, zyrtari i autorizuar përpilon procesverbal.
9. Në rast të sekuestrimit të përkohshëm të sendeve, librave afariste dhe dokumenteve të tjera gjatë kontrollit të paparalajmëruar, Autoriteti harton shkresë zyrtare në të cilën shënon veçanërisht vendin e gjetjes së sendeve dhe përshkrimin e tyre.
10. Zyrtari i autorizuar i Autoritetit pa vonesë i jep palës në procedurë ose zotëruesit të sendeve vërtetim për sendet dhe dokumentet të tjera të sekuestruara përkohësisht.
11. Sendet, librat afariste dhe dokumentet e tjera të sekuestruara përkohësisht mbahen deri në konstatimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të cilat i përmbajnë ato sende, dhe më së voni deri në marrjen e vendimit me të cilin përfundon procedura në Autoritet.

**Neni 41****Kontrolli i paparalajmëruar në objekte të personave të tjerë**

1. Kontrollit të paparalajmëruar sipas nenit 40 të këtij ligji mund t'i nënshtrohen këto objekte, nëse ekziston dyshimi i bazuar se fshehin librat afariste ose dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me procedurën që është duke u zhvilluar nga Autoriteti:

1.1. objekti i ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjes për të cilin nuk ka filluar procedura;

1.2. banesa ose objekti i ngjashëm që ka lidhshmëri me anëtarin e bordit drejtues ose punonjësin e ndërmarrjes ndaj të cilës ka filluar procedura;

1.3. objekti i personit tjetër.

2. Gjatë kontrollit të paparalajmëruar në objektin nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të asistojnë si dëshmitarë dy (2) persona të moshës madhore.

**Neni 42****Zbatimi i kontrollit të paparalajmëruar**

1. Kontrolli mund të zbatohet kundër vullnetit, nëse ndërmarrja, grupimi i ndërmarrjeve ose zotëruesi i objektit:

1.1. refuzon të lejojë hyrjen e zyrtarëve të autorizuar;

1.2. pengon shikimin e librave afariste ose dokumente të tjera; ose

1.3. në mënyrë tjetër vështirëson zbatimin e kontrollit të paparalajmëruar.

2. Kontrollin kundër vullnetit e kryejnë zyrtarët e autorizuar me ndihmën e zyrtarëve të autorizuar të Policisë.

**Neni 43****Përfashtimi i dokumentacionit në kontrollin e paparalajmëruar**

1. Nga dokumentacioni që kontrollohet gjatë kontrollit të paparalajmëruar, përjashtohen letrat, shënimet dhe format e tjera të komunikimit mes ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjeve ndaj të cilës zhvillohet procedura dhe avokatit të autorizuar të ndërmarrjes ose grupimit, të cilat quhen informata të fshehta ose konfidenciale.

2. Autoriteti mund të inspektojë dokumentet nëse ndërmarrja, grupimi i ndërmarrjes ose avokati i autorizuar refuzon t'i japë në shikim duke u thirrur në fshehtësi të informatave nga paragrafi 1 të këtij neni.

3. Nëse çmon se informata nuk është e fshehtë sipas paragrafit 1 të këtij neni, zyrtari i autorizuar i Autoritetit e mbyll dokumentin ose kopjen e vërtetuar në zarf të posaçëm në praninë e përfaqësuesit ose avokatit të autorizuar të ndërmarrjes ose grupimit të ndërmarrjes. Zarfi vulloset me vulë të Autoritetit, shënohet me datë dhe nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar dhe të pranishmit.

4. Autoriteti me akt nënligjor përcakton procedurën që zbatohet në rastet nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.



**Neni 44****Procesverbali i kontrollit të paparalajmëruar**

1. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas kontrollit të paparalajmëruar nga nenet 40 dhe 41 i këtij ligji, zyrtari i autorizuar përpilon procesverbalin për kontrollin.
2. Procesverbali i kontrollit të paparalajmëruar përmban:
  - 2.1. vendin dhe datën e përpilimit të procesverbalit;
  - 2.2. bazën juridike për zbatimin e kontrollit të paparalajmëruar;
  - 2.3. vendin dhe kohën e zbatimit të kontrollit të paparalajmëruar;
  - 2.4. emrat e zyrtarëve të autorizuar që kanë marrë pjesë në kontroll dhe palët e prashme në procedurë;
  - 2.5. përshkrimin e rrjedhjes dhe përmbajtjen e çdo veprimi të kryer gjatë kontrollit të paparalajmëruar dhe deklaratat e dhëna;
  - 2.6. listën e dokumenteve dhe sendeve të tjera të përdorura ose përkohësisht të sekuestruara gjatë kontrollit të paparalajmëruar.
3. Procesverbali i kontrollit të paparalajmëruar u dorëzohet palëve në procedurë dhe personave të të cilët është kryer kontrolli i paparalajmëruar.
4. Palët në procedurë dhe personat të të cilët është kryer kontrolli i paparalajmëruar mund të parashtrajnë me shkrim vërejtjet për procesverbalin e kontrollit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas dorëzimit të procesverbalit.

**Neni 45****E drejta e qasjes në dosje**

1. Pala në procedurë mund të kërkojë me shkrim qasje në dosje pasi i dorëzohet njoftimi, konstatimin paraprak të fakteve sipas nenit 46 të këtij ligji.
2. Mund të kërkojë me shkrim qasje në dokumentet në të cilat është mbështetur vendimi ose konkluzioni propozuesi i fillimit të procedurës pasi i dorëzohet:
  - 2.1. konkluzioni nga paragrafi 3 i nenit 34 të këtij ligji për njohjen e së drejtës për të vepruar si propozues i fillimit të procedurës;
  - 2.2. konkluzioni nga paragrafi 5 i nenit 36 të këtij ligji për konstatimin e mungesës së interesit publik për fillimin e procedurës;
  - 2.3. vendimi për konstatimin e mungesës së çrregullimit të konkurrencës.
3. Palës i sigurohen dokumentet e nevojshme nga Autoriteti, të përcaktuara me këtë ligj dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.
4. Autoriteti cakton datën për qasje në dosje brenda pesë (5) ditëve pas dorëzimit të kërkesës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Pavarësisht paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nuk mund të shikohen, qasen ose të përshkruhen:
  - 5.1. vendimet e Autoritetit, procesverbalet ose regjistrimet zanore e mbledhjeve të Komisionit;

- 5.2. udhëzimet e brendshme dhe shënimet për lëndën;
  - 5.3. letërkëmbimet mes të Autoritetit dhe institucioneve simotra;
  - 5.4. dokumentet e tjera të cilat konsiderohen fshehtësi tregtare sipas nenit 51 të këtij ligji.
6. Pavarësisht paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, personi që nuk është palë në procedurë nuk ka të drejtë të qasjes në dosje, por mund të kërkojë njoftimin në formë të shkurtër për konstatimin e fakteve dhe të ofrojë vërejtje sipas nenit 46 të këtij ligji.

#### **Neni 46** **Njoftimi i konstatimit të fakteve**

1. Para seancës dëgjimore, Autoriteti njofton me shkrim palën në procedurë për konstatimin paraprak të fakteve.
2. Propozuesi i fillimit të procedurës dhe personi që i njihet e drejta për të vepruar si propozues mund t'i kërkojë Autoritetit njoftimin e shkurtër për konstatimin paraprak të fakteve. Njoftimi i shkurtër nuk përmban fshehtësitë tregtare.
3. Brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të njoftimit nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, pranuesi i njoftimit mund:
  - 3.1. të parashtrojë vërejtje për konstatimin paraprak të fakteve;
  - 3.2. të propozojë prova shtesë ose dëgjimin e dëshmitarëve në seancë dëgjimore.
4. Nëse pas njoftimit nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni, Autoriteti pranon prova të reja ose mëson fakte të reja, Autoriteti mund të ndryshojë konstatimin paraprak të fakteve.
5. Nëse ndryshon konstatimin paraprak të fakteve, Autoriteti dorëzon njoftim të ri në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe u cakton pranuesve një afat të arsyeshëm për të parashtuar vërejtje.
6. Autoriteti nuk mund të mbështetë vendimin në fakte dhe rrethana për të cilat palës në procedurë nuk i është dhënë mundësia e mbrojtjes.

#### **Neni 47** **Marrja e detyrimeve**

1. Pas fillimit të procedurës dhe para njoftimit për konstatimin e fakteve, pala në procedurë mund t'i propozojë Autoritetit masa, kushte dhe afatet për të mënjeluar efektet e dëmshme në konkurrencën në treg.
2. Autoriteti me vendim mund t'i miratojë pjesërisht ose tërësisht masat, kushtet dhe afatet e propozuara nëse i çmon të mjaftueshme për të mënjeluar efektet e dëmshme në konkurrencën në treg.
3. Vendimi nga paragrafi 2 i këtij neni:
  - 3.1. i bën masat, kushtet dhe afatet e propozuara të detyrueshme për palën;
  - 3.2. i kërkon palës të parashtrojë prova për zbatimin e masave, kushteve dhe afateve të miratuara;
  - 3.3. konstaton se nuk ka kushte për të vazhduar procedurën.

4. Autoriteti mund të miratojë masat, kushtet dhe afatet e propozuara në këto raste:

4.1. shkelja është e kohëzgjatjes së shkurtër;

4.2. pala ka bashkëpunuar me Autoritetin dhe ka propozuar masat, kushtet dhe afatet brenda gjashtë (6) muajve pas fillimit të procedurës;

4.3. në rast tjetër, nëse i çmon masat, kushtet dhe afatet e propozuara të mjaftueshme për të mënjanuar efektet e dëmshme në konkurrencën e tregut.

5. Autoriteti publikon në ueb-faqen e vet njoftim për miratimin e masave, kushteve dhe afateve të propozuara. Njoftimi përmban:

5.1. përshkrim të lëndës;

5.2. përshkrim të masave, kushteve dhe afateve të miratuara;

5.3. thirrje personave të interesuar të parashtrojnë vërejtjet, qëndrimet dhe mendimet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

6. Pavarësisht paragrafit 3 të këtij neni, Autoriteti mund të rifillojë procedurën nëse:

6.1. vendimi është mbështetur në informata të pasakta ose të rreme të paraqitura nga palët;

6.2. rrethanat në të cilat është mbështetur vendimi kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme;

6.3. pala vepron në kundërshtim me masat, kushtet dhe afatet e miratuara.

7. Autoriteti mbikëqyr zbatimin e masave, kushteve dhe afateve të miratuara. Nëse pala nuk i zbaton, Autoriteti konstaton shkeljen e këtij ligji dhe shqipton gjobë sipas këtij ligji.

#### **Neni 48** **Seanca dëgjimore**

1. Autoriteti mbanë seancë dëgjimore gjatë procedurës.

2. Autoriteti mund të përjashtojë publikun nga seanca dëgjimore për të ruajtur fshehtësinë tregtare.

3. Nëse asnjë nga personat e ftuar ose të autorizuarit e tyre nuk paraqiten në seancë dëgjimore, Autoriteti mund ta shtyjë seancën për një kohë tjetër.

4. Nëse personat e ftuar ose të autorizuarit e tyre nuk paraqiten në seancë dëgjimore as herën e dytë, Autoriteti mban seancën me palët e pranishme ose vendos vetë sipas të dhënave dhe dokumenteve që zotëron.

#### **Neni 49** **Masat e përkohshme**

1. Autoriteti mund të fillojë procedurën dhe të marrë vendim për masa të përkohshme ndaj palës, kur ka rrezik për dëmtim të pariparueshëm të konkurrencës në treg, sidomos kur veprimet e caktuara çrregullojnë konkurrencën.

2. Me vendimin për masa të përkohshme, Autoriteti urdhëron ndërmarrjen të ndalojë veprimin e caktuar ose të zbatojë masa, kushte dhe afate për mënjanimin e efekteve të dëmshme në konkurrencën në treg.

3. Masat e përkohshme zgjatin deri në gjashtë (6) muaj. Autoriteti mund të shtyjë kohëzgjatjen e masave të përkohshme nëse është e domosdoshme.

4. Nëse pala nuk zbaton vendimin për masa të përkohshme, Autoriteti konstaton shkeljen e këtij ligji dhe shqipton gjobë sipas këtij ligji.

#### **Neni 50**

#### **Konstatimi i kushteve për shqiptimin e gjobës**

1. Kur konstaton se pala në procedurë ka çrregulluar konkurrencën e tregut ose ka shkelur dispozitat e këtij ligji, Autoriteti i dorëzon palës njoftimin për konstatimin e fakteve dhe njoftimin për përmbajtjen e vendimit të marrë mbi konstatimin e fakteve.

2. Njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni i bashkëngjitet ftesa për seancë dëgjimore. Palës i jepet mundësia për të siguruar mbrojtje dhe i paraqiten provat mbi të cilat konstatohet shkelja, shqiptohet gjoba dhe caktohet lartësia e gjobës.

3. Pas seancës dëgjimore, Autoriteti vendos për shqiptimin e gjobës, lartësinë e gjobës dhe mënyrën dhe kushtet e përmbartimit.

4. Autoriteti mbyll procedurën me vendimin përfundimtar që konstaton shkeljen dhe shqipton gjobën.

#### **Neni 51**

#### **Fshehtësia tregtare**

1. Fshehtësia tregtare - sekret tregtar ose sekret afarist, janë informatat që kanë vlerë aktuale apo potenciale të tregut dhe informatat zbulimi ose përdorimi i të cilave mund t'i japë përparësi ekonomike ndërmarrjes tjetër.

2. Janë fshehtësi tregtare veçanërisht:

2.1. informata që është përcaktuar fshehtësi tregtare me ligj ose akt nënligjor;

2.2. informata që ndërmarrja e ka shënjuar si fshehtësi tregtare, me kusht që Autoriteti ta ketë pranuar;

2.3. letërkëmbimi mes Autoritetit dhe institucioneve simotra.

3. Anëtarët e Komisionit dhe zyrtarët e tjerë të Autoritetit kanë detyrë të ruajnë fshehtësinë tregtare pesë (5) vjet pasi përfundojnë punën në Autoritet.

4. Gjatë vlerësimit nëse informata përbën fshehtësi tregtare, Autoriteti merr parasysh:

4.1. zotërimin e informatës jashtë ndërmarrjes;

4.2. masat e ndërmarrjes për të mbrojtur fshehtësinë e informatës, sidomos klauzolat për ndalimin e konkurrimit dhe ndalimin e zbulimit të informatave në kontrata të punës dhe kontrata të ngjashme;

4.3. vlerën e informatës për ndërmarrjen dhe konkurrentët.

5. Nuk quhen fshehtësi tregtare:

5.1. informatat e qasshme për publikun, duke përfshirë informatat që mund të sigurohen nga institucionet dhe shërbimet e specializuara dhe informatat botërisht të ditura nga ekspertët;

5.2. raportet vjetore financiare dhe raportet statistikore, përkatësisht të dhënat për të hyrat e përgjithshme që publikohen në raport vjetor financiar ose mund të qasen në mënyrë tjetër;

5.3. të dhënat dhe dokumentet në të cilat mbështetet vendimi i Autoritetit.

6. Nëse pala në procedurë ose personi tjetër nuk i përgjigjet kërkesës së përsëritur për dorëzimin e të dhënave ose dokumenteve sipas nenit 39 të këtij ligji, Autoriteti konstaton se të dhënat dhe dokumentet e kërkuara nuk përbëjnë fshehtësi tregtare.

#### **Neni 52**

#### **Ruajtja e dosjeve dhe dokumentacionit**

Dokumentet që Autoriteti merr nga ndërmarrja gjatë procedurës ose mbledh dhe përpunon për procedurën ruhen në dosje të lëndës në arkivat e Autoritetit sipas Ligjit për Arkivat Shtetërore.

#### **Neni 53**

#### **Zyrtarët e përjashtuar**

1. Zyrtari i Autoritetit përjashtohet nga procedura nëse është:

1.1. palë, dëshmitar ose ekspert i caktuar për lëndën;

1.2. i afërt me palën ose përfaqësuesin a avokatin e palës:

1.2.1. në lidhje vertikale në cilëndo shkallë;

1.2.2. në lidhje të tërthortë dhe farefisnore deri në shkallën e katërt;

1.2.3. në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë; ose

1.2.4. në bashkësi martesore ose jashtëmartesore, edhe nëse ka përfunduar; ose

1.3. birësues, i birësuar, kujdestar, mbrojtës ose bashkëjetues i palës ose përfaqësuesit e avokatit të palës.

2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, zyrtari i Autoritetit mund të përjashtohet nga procedura nëse ekzistojnë rrethana të tjera që vënë në dyshim paanësinë e zyrtarit.

3. Kërkesën për përjashtimin nga procedura të zyrtarit të Autoritetit mund ta parashtrijë me shkrim edhe pala në procedurë.

4. Ky nen zbatohet edhe për anëtarët e Komisionit.

5. Për kërkesën për përjashtim sipas këtij neni vendos Komisioni.

#### **Neni 54**

#### **Afatet e vendimmarrjes**

1. Autoriteti nxjerr këto vendime brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas njoftimit për konstatimin e fakteve:

1.1. vendimi për konstatimin e marrëveshjes së ndaluar sipas nenit 5 të këtij ligji;

1.2. vendimi për konstatimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese sipas nenit 10 të këtij ligji.

2. Nëse mbahet seancë dëgjimore, Autoriteti nxjerr vendimin përfundimtar për rastet nga paragrafi 1 i këtij neni brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore.

3. Autoriteti nxjerr vendimin për vlerësimin e përqendrimit sipas nenit 17 të këtij ligji brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas konkluzionit për fillimin e procedurës.

4. Autoriteti nxjerr këto vendime brenda katër (4) muajve pas konstatimit të fakteve ose përfundimit të seancave dëgjimore:

4.1. vendimi për tërheqjen e marrëveshjes nga përjashtimi grupor sipas nenit 6 të këtij ligji;

4.2. vendimi për shpalljen e marrëveshjes me rëndësi të vogël sipas nenit 7 të këtij ligji;

4.3. vendimi për ndryshimin e vendimit për lejimin e përqendrimit sipas paragrafit 3 të nenit 19 të këtij ligji.

5. Autoriteti nxjerr këto vendime brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas konstatimit të fakteve ose përfundimit të seancave dëgjimore:

5.1. vendimi për shfuqizimin e vendimit për lejimin e përqendrimit sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 19 të këtij ligji;

5.2. vendimi për caktimin e masave për rivendosjen e konkurrencës në treg të përqendrimit i ndaluar sipas nenit 20 të këtij ligji;

5.3. vendimi për miratimin e detyrimit e propozuara nga ndërmarrja sipas nenit 47 të këtij ligji.

6. Pavarësisht paragrafit 3 të këtij neni, Autoriteti mund të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për vlerësimin e përqendrimit për nëntëdhjetë (90) ditë nëse çmon se për të konstatuar faktet nevojitet ekspertizë ose analizë shtesë. Autoriteti njofton palën në procedurë për shtyrjen para përfundimit të afatit.

7. Në raste të veçanta, Autoriteti mund të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për gjashtëdhjetë (60) ditë.

#### **Neni 55** **Aktet e Autoritetit**

1. Mbështetur në nenet 26 dhe 27 të këtij ligji, Autoriteti nxjerr vendime të veçanta me të cilat:

1.1. konstaton marrëveshjen e ndaluar sipas nenit 5 të këtij ligji dhe shqipton gjobën për shkeljen e atij neni;

1.2. tërheq marrëveshjen nga përjashtimi grupor sipas nenit 6 të këtij ligji;

1.3. shpall marrëveshjet me rëndësi të vogël sipas nenit 7 të këtij ligji;

1.4. konstaton keqpërdorimin e pozitës dominuese, shqipton gjobën për këtë shkelje dhe cakton masat nga neni 10 i këtij ligji;

1.5. shpall të lejuar ose të ndaluar përqendrimin sipas nenit 17 të këtij ligji;

1.6. shfuqizon vendimin për lejimin e përqendrimit, mbështetur në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 19 të këtij ligji, dhe shqipton gjobën për shkeljen përkatëse;

- 1.7. ndryshon vendimin për lejimin e përqendrimit dhe cakton masa, mbështetur në paragrafin 3 të nenit 19 të këtij ligji;
  - 1.8. cakton masa për rivendosjen e konkurrencës në treg të përqendrimit të ndaluar, mbështetur në nenin 20 të këtij ligji, dhe shqipton gjobën për shkeljen përkatëse;
  - 1.9. cakton masa të përkohshme sipas nenit 49 të këtij ligji;
  - 1.10. miraton detyrimet e propozuara nga ndërmarrjet sipas nenit 47 të këtij ligji;
  - 1.11. konstaton mospërbushjen e detyrimeve të marra sipas nenit 47 të këtij ligji dhe shqipton gjobën për shkeljen e atij neni;
  - 1.12. shqipton gjobat e parapara me këtë ligj;
  - 1.13. konstaton se nuk është shtrembëruar konkurrenca e tregut sipas këtij ligji;
  - 1.14. urdhëron ndalimin e shkeljes së këtij ligji;
  - 1.15. me vetënishtë ose sipas kërkesës, jep rekomandime që synojnë rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg për organet e administratës publike qendrore dhe lokale dhe për persona juridikë publikë.
2. Mbështetur në nenet 26 dhe 27 të këtij ligji, Autoriteti nxjerr konkluzione të veçanta me të cilat:
- 2.1. fillon procedurën sipas nenit 37 të këtij ligji;
  - 2.2. i kërkon gjykatës kompetente të miratojë kontrollin e paparalajmëruar sipas neneve 40, 41, 42, 43 dhe 44 të këtij ligji;
  - 2.3. konstaton se nuk ka interes publik për të filluar procedurën sipas propozimit, mbështetur në paragrafin 4 të nenit 36 të këtij ligji;
  - 2.4. konstaton se nuk ka kushte për të filluar procedurën sipas propozimit, mbështetur në paragrafin 5 të nenit 36 të këtij ligji;
  - 2.5. i jep Kuvendit të Republikës, Qeverisë ose organit publik mendim profesional sipas nenit 32 të këtij ligji;
  - 2.6. konkludon se Autoriteti nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën sipas këtij ligji.

### **Neni 56**

#### **Dorëzimi dhe publikimi i akteve të Autoritetit**

1. Vendimi i Autoritetit i dorëzohet palës në procedurë dhe propozuesit të fillimit të procedurës.
2. Vendimi dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve pas skadimit të afatit për vendimmarrje nga neni 54 i këtij ligji.
3. Publikohen në Gazetën Zyrtare vendimet nga nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të nenit 55 të këtij ligji.
4. Publikohen në ueb-faqen e Autoritetit vendimet nga paragrafi 1 i këtij neni dhe vendimet gjyqësore lidhur me aktin e Autoritetit.

5. Në vendimin e dorëzuar ose të publikuar, mbulohet ose hiqet pjesa që përmban fshehtësi tregtare sipas nenit 51 të këtij ligji.

## **KAPITULLI VIII DISPOZITAT NDËSHKUESE**

### **Neni 57 Gjobat për shkelje të rënda**

1. Dënohet me gjobë deri në dhjetë për qind (10%) të qarkullimit të përgjithshëm që ka realizuar në tërë botën në vitin e fundit për të cilin është përmbyllur raporti financiar, ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve që:

1.1. lidh marrëveshje të ndaluar ose në mënyrë tjetër merr pjesë në marrëveshje me të cilën është çrregulluar konkurrenca, në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji;

1.2. keqpërdor pozitën dominuese, në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji;

1.3. merr pjesë në përqendrim të ndaluar, në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji;

1.4. nuk i parashton Autoritetit kërkesë për lejimin e përqendrimit, në kundërshtim me nënparagrafin 1.2 të nenit 20 të këtij ligji;

1.5. nuk vepron në pajtim me vendimin e Autoritetit që cakton masa për rivendosjen e konkurrencës ose masa të përkohshme sipas nënparagrafëve 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 1.12 dhe 1.14 të nenit 55 të këtij ligji.

### **Neni 58 Gjobat për shkelje të lehta**

1. Dënohet me gjobë deri në një për qind (1%) të qarkullimit të përgjithshëm që ka realizuar në tërë botën në vitin e fundit për të cilin është përmbyllur raporti financiar, ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve që:

1.1. Autoritetit i paraqet informata të pasakta ose të rreme në procedurën e vlerësimit të përqendrimit sipas nenit 16 i këtij ligji;

1.2. nuk vepron sipas kërkesës së Autoritetit nga paragrafët 1 dhe 3 të nenit 39 të këtij ligji;

1.3. pengon zbatimin e urdhrin të gjykatës kompetente sipas neneve 40, 41, 42, 43 dhe 44 të këtij ligji;

1.4. nuk paraqitet në intervistë sipas nenit 39 të këtij ligji;

1.5. thyen plombimin e vendosur sipas nënparagrafit 6.5 të nenit 40 të këtij ligji;

1.6. jep të dhëna dhe dokumente të pasakta ose keqinformuese ose nuk pranon të japë përgjigje të plotë sipas nënparagrafit 6.6 të nenit 40 të këtij ligji;

1.7. nuk është palë në procedurë dhe nuk vepron sipas kërkesës së Autoritetit, në pajtim me paragrafët 1 dhe 3 të nenit 39 të këtij ligji.

### **Neni 59 Gjobat për shkeljet nga personat përgjegjës**

Dënohet me gjobë prej një mijë (1.000) deri në katër mijë (4.000) euro, personi përgjegjës i ndërmarrjes ose organit shtetëror për çdo shkelje nga nenet 57 dhe 58 të këtij ligji.



### **Neni 60**

#### **Pagesat ndëshkuese periodike**

1. Dënohet me gjobë në pagesë ditore deri në pesë për qind (5%) të qarkullimit mesatar ditor nga viti i fundit për të cilin është përmbyllur raporti financiar, duke llogaritur nga dita e vendimit, ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve deri kur:

1.1. të ndalojë shkeljen nga neni 5, neni 9 ose paragrafi 1.4 i nenit 58 të këtij ligji;

1.2. të zbatojë vendimin për masa të përkohshme sipas nenit 49 të këtij ligji;

1.3. të përmbushë angazhimin që është bërë i detyrueshëm me vendim të miratuar sipas nenit 47 të këtij ligji;

1.4. të sigurojë të plota dhe të sakta informatat dhe dokumentet e kërkuara sipas nenit 39 të këtij ligji;

1.5. të pranojë kontrollin e urdhëruar sipas nenit 40 të këtij ligji.

### **Neni 61**

#### **Mënyra dhe kriteret e shqiptimit të gjobave**

1. Shuma më e lartë e gjobës së shqiptuar sipas këtij ligji nuk mund të tejkalojë dhjetë për qind (10%) të qarkullimit të përgjithshëm që ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve ka realizuar në tërë botën gjatë vitit të fundit për të cilin është përmbyllur raporti financiar.

2. Në shqiptimin e gjobës, Autoriteti merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas peshës së shkeljes, kohëzgjatjes së shkeljes dhe pasojave të shkeljes për ndërmarrjet e tjera në treg dhe konsumatorët. Autoriteti fillimisht cakton lartësinë themelore të gjobës për shkeljen, pastaj zvogëlon ose rrit lartësinë e gjobës varësisht nga rrethanat lehtësuese ose rënduese.

3. Lartësia themelore e gjobës caktohet deri në tridhjetë për qind (30%) të të hyrave që ndërmarrja ka realizuar përjashtimisht në tregun përkatës në të cilin është konstatuar shkelja dhe gjatë kohës sa ka zgjatur shkelja.

4. Rrethana lehtësuese sipas paragrafit 2 të këtij neni janë veprimet të cilat:

4.1. me përjashtim të pjesëmarrësve në marrëveshje të ndaluar, ndërmarrja dorëzon prova për ndërprerjen e veprimit të kundërligjshëm pasi njoftohet për fillimin e procedurës;

4.2. ndërmarrja dorëzon të dhëna për shkeljen e kryer nga pakujdesia;

4.3. ndërmarrja dorëzon të dhëna se nuk ka zbatuar marrëveshjen e ndaluar në të cilën është palë ose se ka vepruar në pajtim me ligjin përkundër marrëveshjes së ndaluar;

4.4. bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin tejkalon detyrimin e ndërmarrjes për lirin nga gjoba ose zvogëlimin e gjobës sipas nenit 62 të këtij ligji.

5. Rrethana rënduese sipas paragrafit 2 të këtij neni janë veprimet të cilat:

5.1. pala vazhdon ose përsërit veprimin e kundërligjshëm, të njëjtë ose të ngjashëm, edhe pasi i është dorëzuar vendimi i Autoritetit që konstaton se veprimi çrregullon konkurrencën;

5.2. ndërmarrja refuzon të bashkëpunojë me Autoritetin ose pengon zhvillimin e procedurës;

- 5.3. ndërmarrja nxit ndërmarrjen tjetër për të kryer shkelje ose merr veprime për të siguruar pjesëmarrjen e ndërmarrjes tjetër në shkelje të këtij ligji.
6. Në rastin nga nënparagrafi 5.1 i këtij neni, lartësia themelore e gjobës rritet një qind për qind (100%).
7. Autoriteti mund të rrisë lartësinë e gjobës sipas nevojës me sekuestrimin e pasurisë që ndërmarrja ka fituar në kundërshtim me këtë ligj, nëse përfitimi mund të llogaritet.
8. Pavarësisht paragrafit 4 të këtij neni, Autoriteti mund të zvogëlojë lartësinë e gjobës, nëse ndërmarrja që ka bërë shkelje është në gjendje të vështirë financiare dhe dëshmon se shqiptimi i gjobës mund t'ia dëmtojë pakthyeshem qëndrueshmërinë ekonomike dhe vlerën e pronës.
9. Kur ka ndryshime juridike ose organizative brenda një ndërmarrje që merr pjesë në një shkelje, Autoriteti mund ta ndjekë dhe t'i shqiptojë gjobë pasardhësit juridik ose ekonomik të ndërmarrjes.
10. Autoriteti me akt nënligjor përcakton procedurën, mënyrën dhe kriteret e shqiptimit të gjobave të parapara me këtë ligj. Autoriteti përcakton kriteret në pajtim me normat e konkurrencës të Bashkimit Evropian, sipas nenit 70 të këtij ligji.

#### **Neni 62**

#### **Lirimi nga gjoba dhe zvogëlimi i gjobës**

1. Me qëllim të zbulimit të shkeljeve më të rënda të këtij ligji, Autoriteti mund të lirojë nga gjoba:
- 1.1. pjesëmarrësin e marrëveshjes së ndaluar që i pari njofton Autoritetin dhe i ofron të dhëna, fakte dhe prova që mundësojnë fillimin e procedurës;
  - 1.2. pjesëmarrësin e marrëveshjes së ndaluar që i pari njofton Autoritetin dhe i ofron prova që mundësojnë konstatimin e shkeljes së këtij ligji, kur Autoriteti ka filluar procedurën, por nuk ka pasur fakte të mjaftueshme për të përfunduar procedurën ose për të konstatuar marrëveshjen e ndaluar.
2. Lirimi nga gjoba sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohet për ndërmarrjen që ka qenë nis-mëtare ose nxitëse e marrëveshjes së ndaluar.
3. Autoriteti mund t'i shqiptojë gjobë më të vogël pjesëmarrësin e marrëveshjes së ndaluar që nuk përmbush kushtet për lirim nga gjoba sipas paragrafit 1 të këtij neni por që Autoritetit i ka ofruar prova vendimtare për konstatimin e marrëveshjes së ndaluar.
4. Autoriteti me akt nënligjor përcakton procedurën dhe kriteret për lirim nga gjoba dhe zvogëlimin e gjobës sipas këtij neni.

### **KAPITULLI IX**

### **BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA DHE MBROJTJA GJYQËSORE**

#### **Neni 63**

#### **Mjetet juridike kundër shkaktimit të dëmit**

1. Ndërmarrja që shkel këtë ligj duhet të kompensojë dëmin që i ka shkaktuar ndërmarrjes ose personit tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kushdo që i cenohet interesi i ligjshëm me veprim kufizues nga neni 5 ose 9 i këtij ligji mund të kërkojë përmes gjykatës:

2.1. përfundimin e veprimit të paligjshëm;

2.2. kompensimin e dëmit të shkaktuar.

#### **Neni 64**

##### **Bashkëpunimi i Autoritetit me gjyqësorin dhe organet e tjera**

1. Autoriteti bashkëpunon me organet gjyqësore dhe organet e tjera kompetente në çështje që kanë të bëjnë me shtrembërimin e konkurrencës në treg në Republikën e Kosovës.

2. Sipas kërkesës me shkrim të Autoritetit, Ministria përgjegjëse për punët e brendshme siguron ndihmë në kontrollin e paparalajmëruar ose sekuestrimin e sendeve dhe dokumenteve, sipas neneve 40, 41, 42, 43 dhe 44 të këtij ligji.

3. Me kërkesën e Autoritetit sipas nenit 39 të këtij ligji, organi publik i dorëzon Autoritetit informatat dhe dokumentet e kërkuara, duke përfshirë të dhënat dhe dokumentet që përmbajnë fshehtësi tregtare.

4. Gjatë rregullimit të veprimtarive ekonomike brenda Republikës së Kosovës, organet e administratës qendrore dhe lokale zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe marrin parasysh rekomandimet e Autoritetit sipas nenit 32 të këtij ligji.

5. Me vetënishtë ose kërkesë të ministrisë përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti, Autoriteti mban tryezë ose konferencë ku organet publike, shoqatat e ndërmarrjeve dhe shoqatat e konsumatorëve mund të parashirojnë vërejtje mbi gjendjen e tregut.

#### **Neni 65**

##### **Bashkëpunimi i Autoritetit me institucionet simotra**

1. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Autoriteti mund të bashkëpunojë në mënyrë të ndërsjellë me institucione simotra.

2. Autoriteti mund t'u dërgojë dhe t'u kërkojë institucioneve simotra informata dhe dokumente për çështje faktike ose juridike, duke përfshirë informatat e fshehta dhe veçanërisht fshehtësinë tregtare.

3. Autoriteti mund të përdorë si provë informatën e pranuar nga institucioni simotër.

4. Autoriteti mund të dërgojë informata dhe dokumente me kusht që institucioni pranues:

4.1. të përdorë informatën si dëshmi vetëm për qëllim të zbatimit të ligjit të konkurrencës dhe në lidhje me objektin e hetimit për të cilin informata është marrë nga Autoriteti;

4.2. të ruajë fshehtësinë e informatës dhe të mos ia zbulojë informatën gjykatës, organit administrativ ose palës së tretë pa pëlqimin e Autoritetit.

5. Autoriteti mund të dërgojë informatën e fshehtë nga procedura e vlerësimit të përqendrimit vetëm me pëlqimin e ndërmarrjes që ka dhënë informatën.

#### **Neni 66**

##### **Mbrojtja gjyqësore**

1. Nuk lejohet ankesë por pala mund të nisë konflikt administrativ me padi në gjykatën kompetente ndaj këtyre akteve të Autoritetit:

1.1. vendimi për konstatimin e shkeljes së këtij ligji dhe për shqiptimin e gjobës;

- 1.2. vendimi për konstatimin e mungesës së çrregullimit të konkurrencës;
  - 1.3. vendimi për ndërprerjen e procedurës për shkak të çështjes paraprake;
  - 1.4. vendimi për masa të përkohshme nga neni 49 i këtij ligji;
  - 1.5. konkluzioni i nxjerrë gjatë procedurës;
  - 1.6. konkluzioni nga paragrafi 3 i nenit 34 të këtij ligji për njohjen e së drejtës për të vepruar si propozues i fillimit të procedurës;
  - 1.7. konkluzioni nga paragrafi 5 i nenit 36 të këtij ligji për konstatimin e mungesës së interesit publik për fillimin e procedurës;
  - 1.8. konkluzioni nga paragrafi 6 i nenit 36 të këtij ligji për konstatimin e mungesës së kushteve për fillimin e procedurës.
2. Nuk lejohet ankesë ose konflikt administrativ ndaj këtyre akteve të Autoritetit:
- 2.1. konkluzioni nga neni 37 i këtij ligji për fillimin e procedurës;
  - 2.2. konkluzioni nga paragrafi 4 i nenit 17 të këtij ligji për bashkimin e lëndëve për lejimin e përqendrimit.
3. Nuk lejohet ankesë ose konflikt administrativ i veçantë ndaj konkluzionit nga neni 45 i këtij ligji për refuzimin e qasjes në dosje. Konkluzioni i tillë mund të goditet me padi për konflikt administrativ ndaj vendimit kryesor të çështjes.
4. Konflikti administrativ nuk e ndalon përmbardimin e aktit të Autoritetit, përveç nëse gjykata shtyn përmbardimin sipas legjislacionit në fuqi.
5. Padinë kundër vendimit për konstatimin e shkeljes së këtij ligji dhe shqiptimin e gjobës e parashtron pala e pakënaqur.
6. Padinë kundër vendimit për konstatimin e mungesës së çrregullimit të tregut mund ta parashtojë propozuesi i fillimit të procedurës ose pala që i është njohur e drejta për të vepruar si propozues.

## **KAPITULLI X PËRMBARIMI I GJOBAVE DHE PARASHKRIMI**

### **Neni 67 Përmbardimi i gjobave**

1. Vendimi i Autoritetit për shqiptimin e gjobës për shkelje të këtij ligji përcakton afatin dhe mënyrën e pagesës së gjobës.
2. Gjopa paguhet pasi hyn në fuqi vendimi i Autoritetit ose pas vendimit të prerë gjyqësor kur gjykata ka pezulluar vendimin e Autoritetit. Në shumën e gjobës llogaritet kamata rrjedhëse ligjore, nga dita që palës i dorëzohet vendimi i Autoritetit deri në ditën e pagesës.
3. Autoriteti mund të lejojë pagesën e gjobës në këste, në përputhje me kriteret e nenit 61 të këtij ligji.
4. Nëse pala nuk paguan gjobën brenda afatit, gjopa përmbardohet në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbardimore.

### **Neni 68** **Parashkrimi i ndjekjes**

1. Autoriteti mund të fillojë procedurë dhe të shqiptojë gjobë brenda afatit të parashkrimit prej pesë (5) viteve nga dita e shkeljes së këtij ligji.
2. Në rast të shkeljeve të vazhdueshme apo të përsëritura të këtij ligji, afati i parashkrimit rrjedh nga dita kur ka pushuar shkelja e ligjit.
3. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të Autoritetit për konstatimin e shkeljes së këtij ligji dhe shqiptimin e gjobës.
4. Kur Autoriteti ndërmer veprim lidhur me disa ndërmarrje ose një grupi të ndërmarrjeve, parashkrimi ndërpritet ditën kur cilësdo ndërmarrje që ka statusin e palës në procedurë i dorëzohet shkresa për veprimin e Autoritetit.
5. Afati i parashkrimit rrjedh përsëri pasi pushon ndërprerja. Përkundër ndërprerjes, Komisioni nuk mund të zhvillojë procedurë ose të shqiptojë gjobë pas afatit të parashkrimit absolut prej dhjetë (10) viteve nga dita e shkeljes së këtij ligji.

### **Neni 69** **Parashkrimi i përmbarrimit**

1. Gjoha e shqiptuar për shkelje të këtij ligji përmbarrhet brenda afatit të parashkrimit prej pesë (5) viteve.
2. Afati i parashkrimit rrjedh nga dita:
  - 2.1. që palës i dorëzohet vendimi i Autoritetit;
  - 2.2. që palës i dorëzohet vendimi i prerë gjyqësor, kur gjykata ka pezulluar vendimin e Autoritetit;
  - 2.3. që pala nuk ka paguar detyrimin e arritshëm, kur Autoriteti ka miratuar pagesën e gjobës në këste.
3. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent për përmbarrimin e gjobës.
4. Afati i parashkrimit rrjedh përsëri pasi pushon ndërprerja. Përkundër ndërprerjes, gjoha nuk mund të përmbarrhet pas afatit të parashkrimit absolut prej dhjetë (10) viteve.

## **KAPITULLI XI** **DISPOZITAT KALIMTARE**

### **Neni 70** **Legjislacioni në fuqi dhe detyrimet ndërkombëtare**

1. Procedurat zhvillohen sipas ligjit në fuqi në kohën e fillimit të procedurës.
2. Ky ligj zbatohet në pajtim me detyrimet e Republikës së Kosovës nga Marrëveshja e Stabilitet-Asociimit me Bashkimin Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike.

### **Neni 71** **Aktet nënligjore**

Brenda tetëmbëdhjetë (18) muajve, Autoriteti nxjerr aktet nënligjore të parapara me këtë ligj dhe harmonizon statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme.

**Neni 72**  
**Dispozita shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Ligji nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

**Neni 73**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-056**  
**13 Maj 2022**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-159/2022, datë 01.06.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**